



# REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

17.12.2021



## KOMUNA E SUHAREKËS

OPSTINE SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MUNICIPALITY OF SUHAREKA - PRIMLJENO RECEIVED			
Nësisë org. Org. Jedinica Org. Unit	Numrit Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	77282	2

### ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dispozitave të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës lidhë këtë:

### MARRËVESHJE E MIRËRKUPTIMIT

Lidhur ndërmjet palëve:

Komunës së Suharekës-përfaqësuar nga Bali MUHARREMAJ  
Kryetar i Komunës në Suharekë

dhe

Shoqatës Humanitare Bëmirëse të Kosovës "Nëna Tereze" –Prishtinë- në tekstin e mëtejme-SHHBK përfaqësuar nga z. Zef Shala Drejtor Ekzekutivë

## **Neni 1**

### **Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirkuptimi është përkrahja e përbashkët nga palët për personat e moshuar dhe të vetmuar të atakuar edhe nga pandemia COVID-19 të cilët jetojnë në qytete apo viset rurale me fokus Gratë e që ju takojnë grupeve të cenueshme në shoqëri të të gjitha grupeve etnike.

## **Neni 2**

### **Përmbajtja dhe Implementimi i projektit**

SHHBK “ Nëna Tereze” për mesë punëtorëve të saj ( Home Care) do të ju ndihmoj personave të kategorisë së lartë përmendur për të pasur çasje në Institucionet Publike dhe Shëndetësore duke ju ofruar shërbime sipas kërkesës së tyre, bazuar në Grantin e financuar nga zyra e Bashkimit Europian ( BE ) në Kosovë dhe nga programi i Kombëve të Bashkuara për Zhvillim ( UNDP ) në Kosovë.

## **Neni 3**

### **Detyrimet e Komunës së Suharekës**

Komuna e Suharekës përmesë Qendrave për Punë Sociale të referuara si QPS dhe Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të referuara si DSHMS do të siguroi evidence - Listën e personave të moshuar dhe të vetmuar e që jetojnë në qytet apo fshatra me fokus të grave te cilat grupe e kanë të vështirësuar qasjen nëinstitucionet publike Komunale.

## **Neni 4**

### **Detyrimet e SHHBK “ NënaTereze”**

- 4.1** SHHBK “ Nëna Tereze” do të i mbështesë personat e kategorive të tilla sipas mundësive programore të parapara me projekt.
- 4.2** Përmesë raporteve me shkrim do të i njoftoj Institucionet Komunale ( QPS-në apo DSHMS-ën në baza tre mujore mbi aktivitetet e zhvilluara për personat e përfshirë në projekt.
- 4.3** Do të merr pjesë në takim me QPS-en apo DSHMS-en çdo herë kur kërkohet për te prezantuar të arriturat e projektit.

## **Neni 5**

### **Koordinimi i veprimeve dhe bashkërendimi i ndihmës dhe përkrahjes**

SHHBK “ Nëna Tereze” do të njoftojë QPS-ën apo DSHMS-ën për personat përfitues nga projekti të përzgjedhur sipas kritereve të parapara me rregullore të veqantë, me qëllim të shmangëjes së dyfishimit të mbështetjes eventuale nga burimet e tjera jasht këtij projekti.

**Neni 6**  
**Mbrojtja e të dhënave personale**

Informatat dhe Listat e pranuar të siguruar nga komuna përmesë QPS-ve apo DSHMS-ve për personat përfitues nga ky projekt duhet të trajtohen në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele.

**Neni 7**  
**Dispozitat përfundimtare**

- 7.1 Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë nga të dyja palët, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.
- 7.2 Palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandum. Mos marraveshjet eventuale zgjidhen me mirëkuptim.
- 7.3 Memorandumi i Mirëkuptimit është i shkruar në Gjuhën Shqipe, në dy kopje identike, nga një për secilën pale dhe hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**PALËT NË MARRËVESHJE**

Shoqatës Humanitare Barmëse të Kosovës  
"Nëna Tereze"

z.Zef Shala

Drejtor Ekzekutivë



Komuna e Suharekës

Bak MUIHARREMAJ

Kryetar i Komunës

